



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1933, datë 07.05.2012

Për

“Disa korrigjime në VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 07.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për disa korrigjime në VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.””.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja c) e nenit 8, neni 52, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Nenet 120 dhe 129 të ligjit nr. 8485, datë 12. 05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, (**KprA**) i ndryshuar;

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);
4. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (**Rregullorja**);
5. Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “ Portabilitetin e Numrit” (e ndryshuar), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010.
6. Rregullore nr. 24 datë 02.02.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD Nr.1774, datë 02.02.2012.
7. Vendimi nr. 1468, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Eagle Sh.A”, i ndryshuar;
8. Vendimi nr. 1741 datë 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP “Për shfuqizimin e VKD nr.1438 datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr.1346, datë 23.07.2010 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile Sh.A., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
9. VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.,” (**VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012**);

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare mbi çështjen, të përbërë nga:

1. Shkresa e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me Nr.Prot. 946, datë 24.04.2012 “Në lidhje me Vendimin e AKEP Nr. 1885, datë 19. 04. 2012”.
2. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**) ;
3. Projektvendim i KD të AKEP për “Disa shtesa dhe ndryshime në VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.”” (**Projektvendimi**);
4. Materiale shkresore shoqëruese në praktikën dokumentare për këtë çështje;

si dhe, diskutimeve në mbledhje dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., me shkresën Nr.Prot. 946, datë 24.04.2012 “Në lidhje me Vendimin e AKEP Nr. 1885, datë 19. 04. 2012”, pasi është njohur me përmbajtjen e VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012, parashtron kërkesën për korrigjime në VKD nr. 1885:
 - a) Tek Aneksi II “Shërbimet dhe tarifat e Interkoneksionit”, pika 2.4.1, numri 102, teksti në Kolonat “Tarifa për Kohëzgjatje”, të bëhet si më poshtë”

“Tarifë Komerciale

Eagle Mobile ka të drejtën e ndryshimit të tarifave për këtë shërbim. Kjo tarifë është objekt njoftimi paraprak nga Eagle Mobile”,

duke arsyetuar se kjo kërkesë ka qenë e parashtruar prej tyre edhe në shkresën Nr.Prot. 456, datë 17.02.2012 “Dërgohen propozime për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të shoqërisë Eagle Mobile”, pasi një afat i shkurtuar është në funksion të dinamikës së këtyre marrëdhënieve të cilat nuk janë më nën rregullim si dhe në frymën e përgjithshme të marrëdhënieve të lira tregtare mes dy subjekteve, ku është e pamundur të parashikohet dhe njoftohet ndryshimi i një tarife komerciale me një afat paraprak 3 mujor.

b) Korrigjimin e pasaktësive tek Aneksi 1 i VKD Nr. 1885:

i. Tek pika 2.3:

- të hiqet togfjalëshi *“dhe në tregun me shumicë të aksesit dhe të origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Republikën e Shqipërisë”*;
- VKD nr. 1507 të ndryshohet me VKD nr. 1508;

ii. Tek pika 4 të ndryshohet *“RIO të Vodafone Albania”* me *“RIO të Eagle Mobile”*.

2. Përveç sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me shkresë përkatëse (Nr. Pr. 5447/16, datë 24. 04. 2012 *“Periudha e njoftimit në RIO-n e aprovuar” dhe Ref.: LGD/0134/X, datë 24. 04.2012 “Kërkohet korrigjim i aktit administrativ VKD nr. 1886, datë 19. 04. 2012)* i janë drejtuar AKEP-it edhe sipërmarrësit AMC Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., duke kërkuar gjithashtu korrigjime aktet e nxjerra nga AKEP-i: VKD nr. 1883, datë 19. 04. 2012 të AKEP *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim të sipërmarrësit AMC Sh.A.”* dhe VKD nr. 1886, datë 19. 04. 2012 të AKEP *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A.”*.

Nga pikpamja thelbësore, kërkesat e sipërmarrësve AMC Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., konsistojnë pothuajse në të njëjtin ndryshim të kërkuar edhe nga sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., tek Aneksi II *“Shërbimet dhe tarifat e Interkoneksionit”*, pika 2.4.1, numri 102, teksti në Kolonat *“Tarifa për Kohëzgjatje”*, por duke kërkuar ndryshimin e pikës 7.2 tek Seksioni 7 i Pjesës Kryesore të RIO-s dhe shtesa tek pika 2.1.1 Aneksi II i RIO-s në zbatim, për shërbimin 102 dhe nivelin e tarifës.

Gjithashu, AMC Sh.A., kërkon që në Seksionin 10, pika 4 të RIO-s në zbatim të rikonsiderohet propozimi i tyre me këtë përmbajtje :

“Faturat janë të pagueshme në Lekë pavarësisht nga monedha në të cilën ka lindur detyrimi. Në rastet e detyrimeve në monedhë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të ditës së faturimit. Kjo dispozitë do të zbatohet edhe për pagesat e shërbimeve që nuk janë pjesë e kësaj RIO”.

3. Pasaktësitë e konstatuara nga ana e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., në pikën 2.3 dhe pikën 4 të Aneksit 1 të VKD nr. 1885 janë të bazuara, pasi:

- Sipërmarrësi, Eagle Mobile sipas VKD nr. 1212, datë 31. 03. 2010 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, i ndryshuar, nuk është përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe të origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë arsye togfjalëshi i vendosur në pikën 2.3 të Aneksit 1 të VKD nr. 1885 “...dhe në tregun me shumicë të aksesit dhe të origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Republikën e Shqipërisë” nuk është i saktë.
- VKD nr. 1507 i përket vendimit të nxjerrë për sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.A., dhe jo sipërmarrësin Eagle Mobile Sh.A. Për sipërmarrësin Eagle Mobile Sh.A., numri i VKD është 1508.
- Në këtë vendim, tek pika 4 e Aneksit 1 të VKD nr. 1885, bëhet fjalë për RIO-n e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., dhe jo të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A.

Duke qenë se këto pasaktësi nuk çenojnë vlefshmërinë e aktit si dhe nuk arrijnë të çenojnë vullnetin e organit vendimmarrës, por që domosdoshmërisht duhen korrigjuar, bazuar në nenin 120 të KPr ku përcaktohet se “Kur akti është i vlefshëm por konstatohet se ai përmban pasaktësi ose gabime të dukshme, organi kompetent, me iniciativën e tij ose me kërkesën e pjesëmarrësve në proces, ndreq gabimet me karakter material si dhe pasaktësitë e dukshme të aktit, pa prekur përmbajtjen e tij. Ndrejqa nuk lidhet me ndonjë afat”, si dhe në nenin 129 të këtij ligji, korigjimet e kërkuara janë të pranueshme dhe duhen bërë nga organi administrativ, AKEP-i.

4. Kërkesa e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., për ndryshimin e afatit të njoftimit tek pika 7.2 e Seksionit 7 të Pjesës Kryesore së RIO-s në zbatim, dhe Aneksi II “Shërbimet dhe tarifatat e Interkoneksionit”, pika 2.4.1, numri 102, teksti në Kolonat “Tarifa për Kohëzgjatje”, ka qenë pjesë e kërkesave të parashtruara prej tij në shkresën Nr.Prot. 456, datë 17.02.2012 “Dërgohen propozime për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të shoqërisë Eagle Mobile”. Gjatë procesit të shqyrtimit dhe nxjerrjes së VKD nr. 1885, për shkak të harresës në pasqyrimin e këtij ndryshimi edhe në këtë pikë të Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, ndryshimi i miratuar është kryer nga AKEP-i duke lënë të pandryshuar përmbajtjen e pikës 7.2 të Pjesës Kryesore të RIO-s në zbatim, ç’ka për përbën një mospërputhje midis vullnetit të shprehur nga organi administrativ dhe mënyrës së të shprehurit në ndryshimet e miratuara. Arsyetimi i ndryshimit të kërkuar tek Aneksi II “Shërbimet dhe tarifatat e Interkoneksionit”, pika 2.4.1, numri 102, teksti në Kolonat “Tarifa për Kohëzgjatje” (duke patur parasysht këtu edhe korigjimet e kërkuara edhe nga sipërmarrësit AMC Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., për këtë çështje) justifikon nevojën e marrjes në konsideratë të ndryshimit të kërkuar por, duke ruajtur frymën e qëndrimit të mbajtur nga AKEP lidhur me nxjerrjen jashtë rregullimit të tarifës për shërbimin 102 sipas RIO-s në zbatim të sipërmarrësit dhe, përcaktimin e saj nga palët në bazë të interesit komercial dhe lirisë së negocimit.

Meqenëse tek pika 7.2 e Seksionit 7 tek Pjesa Kryesore e RIO-s, ka një përcaktim të miratuar nga AKEP-i, i cili në rrethanat e reja të krijuara në treg pas vendimit të AKEP-it për nxjerrjen jashtë rregullimit të tarifës për shërbimin 102 sipas RIO-s përbën sens, konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm ndryshimi i kësaj pike me këtë përmbajtje:

“7.2 Tarifatat e Shërbimeve të Interkoneksionit mund të ndryshohen në përputhje me

parashikimet e Ligjit nr 9918 dhe kuadrin rregullator perkates. Tarifat e ndryshuara duhet te publikohen dhe t'i behen te ditura Operatorit Perfitues pas njoftimit paraprak dhe miratimit nga AKEP. Per tarifat e publikuara ne kete oferte reference dhe qe nuk jane objekt rregullimi nga AKEP, **pervec tarifes per sherbimin e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te EAGLE MOBILE (102), Eagle Moble ka te drejte t'i ndryshoje duke bere publikimin ne oferte dhe njoftuar operatorin perfitues te pakten 3 muaj para hyrjes ne fuqi te tarifes se re.**

Tarifen e sherbimit te terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te EAGLE MOBILE (102), Eagle Mobile ka te drejte ta ndryshoje duke njoftuar per kete me pare me shkrim Operatorin Perfitues."

5. Kërkesa për rikonsiderimin e propozimit lidhur me pikën 10.4 të Seksionit 10 tek Pjesa Kryesore e RIO-s në zbatim është e pranueshme për t'iu krijuar më tepër fleksibilitet palëve në respektim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë lidhur me faturimin (pamvarsisht se në thelb kjo është një kërkesë e parashtruar nga sipërmarrësi AMC Sh.A., por duke patur parasysh këtu standardin e ndjekur nga AKEP për qasjen e një përmbajtje sa më të unifikuar të Ofertave Referencë të Interkoneksionit të publikuara nga sipërmarrësit celularë), duke bërë korrigjimin me këtë përmbajtje:

"10.4 Faturat janë te pagueshme ne monedhen dhe modalitetet e percaktuara nga palet ne Marrveshjen e Interkoneksionit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar per kete qellim. Ato do te datohen si per daten e leshimit te fatures (Daten e leshimit) dhe janë te pagueshme ne ose perpara Dates perkatese per pagese, e cila eshte tridhjetë (30) Dite Kalendarike nga Data e Leshimit.

6. Kërkesat e sipërmarrësit sa më sipër, si dhe arsyetimi i AKEP për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, reflektojnë qëndrimet rregullatore të AKEP-it të vendosura nëpërmjet akteve normative dhe individuale administrative të nxjerra pas periudhës së publikimit dhe hyrjes në fuqi të kësaj Oferte Referencë të Interkoneksionit në zbatim. Ato përmirësojnë ndieshëm kuadrin rregullator lidhur me kushtet për lidhjen e marrëveshjeve të interkoneksionit në përputhje me detyrimet ligjore dhe kushtet aktuale të tregut. Garantojnë më mirë këkesën ligjore për kushtet e veçanta, për ndershmërinë, mosdiskriminimin, transparencën dhe arsyeshmërinë gjatë procesit të negociimit midis sipërmarrësve për lidhjen e Marrëveshjeve të Interkoneksionit. Pas miratimit të shtesave dhe ndryshimeve në Ofertën Referencë të Interkoneksionit, është e nevojshme që ato të reflektohen edhe në marrëveshjet e interkoneksionit të lidhura nga sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., me operatorët e tjerë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, në zbatim të shkronjës c) të nenit 8 dhe nenin 52 të ligjit nr. 9918, nenit 120 dhe 129 të KPrA dhe Rregullores Nr. 19, datë 14.06.2010 "Për Aksesin dhe Interkoneksionin", e ndryshuar,

V E N D O S :

I. Të pranojë pjesërisht kërkesat e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., për korrigjime në Aneksin 1 të VKD Nr. 1885, datë 19. 04. 2012, dhe t'i miratojë ato si më poshtë:

1. Tek pika 2.3 bëhen korrigjimet:

- Hiqet togfjalëshi ... “dhe në tregun me shumicë të aksesit dhe të origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Republikën e Shqipërisë”;
- VKD nr. 1507 bëhet VKD nr. 1508.

2. Tek pika 4, pika 32.2 korrigjohet duke vendosur në vend të fjalës “...RIO se Vodafone Albania” fjalen “...RIO se Eagle Mobile”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

4.1.1 Tek Pjesa Kryesore, Seksioni 7, pika 7.2, ndryshon dhe bëhet:

“7.2 Tarifat e Sherbimeve te Interkoneksionit mund te ndryshohen ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr 9918 dhe kuadrin rregullator perkates. Tarifat e ndryshuara duhet te publikohen dhe t'i behen te ditura Operatorit Perfitues pas njoftimit paraprak dhe miratimit nga AKEP. Per tarifate e publikuara ne kete oferte reference dhe qe nuk jane objekt rregullimi nga AKEP, **pervec tarifes per sherbimin e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te EAGLE MOBILE (102), Eagle Mobile ka te drejte t'i ndryshoje duke bere publikimin ne oferte dhe njoftuar operatorin perfitues te pakten 3 muaj para hyrjes ne fuqi te tarifes se re.**

Tarifen e sherbimit te terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te EAGLE MOBILE (102), Eagle Mobile ka te drejte ta ndryshoje duke njoftuar per kete me pare me shkrim Operatorin Perfitues.

4. Pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Pika 10.4 e Seksionit 10 tek Pjesa Kryesore e RIO-s në zbatim, ndryshon dhe bëhet:

10.4 Faturat jane te pagueshme **ne monedhen dhe modalitetet e percaktuara nga palet ne Marreveshjen e Interkoneksionit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar per kete qellim.** Ato do te datohen si per daten e leshimit te fatures (Daten e leshimit) dhe jane te pagueshme ne ose perpara Dates perkatese per pagese, e cila eshte tridhjete (30) Dite Kalendarike nga Data e Leshimit”.

II. Vendimi të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al dhe sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., të pasqyrojë në RIO-n në zbatim edhe korrigjimet e ndodhura sipas këtij vendimi, duke i publikuar ato brenda një afati jo më të gjatë se 7 ditë pas hyrjes në fuqi të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURCE**